



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021si dhe nenit 10 të Rregullores për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus 15Nr.011-7239 të datës 31.01.2019, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR NDARJEN E
RENDEVE TË UDHËTIMIT TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për ndarjen e rendeve të udhëtimit të transportit të udhëtarëve me autobus, (në vazhdim të tekstit Komisioni), sipas shpalljes publike Nr.01-345/01-21606 të datës 28.04.2022, në përbërje si vijon:

1. Daut Reçica, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtare
3. Rrahman Olluri, anëtar
4. Bujar Curri, anëtar
5. Valdete Muji , anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e operatorëve të transportit të udhëtarëve me autobus, të cilët kanë aplikuar sipas Shpalljes publike të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi për ndarjen e rendeve të udhëtimit brenda afatit 30 ditor nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
2. Komisioni konform nenit 10 par. 5 të Rregullores për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus, pas shqyrtimit të aplikacioneve, harton propozimet konkrete për ndarjen e rendeve të udhëtimit operatorëve transportues, të cilët i plotësojnë më së miri kushtet e konkursit.
3. Propozimet nga paragrafi paraprak, Komisioni ia dërgon Drejtorit të Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim për miratim dhe marrjen të Vendimit.
4. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.


1Nr. 020/04-21609
Lipjan, më 05.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

për





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Vendimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës të datës 23.09.2020 , Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej 8640,75 € (tetë mijë e gjashtëqind e katërdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), për pagesën e anëtarësisë në Asociacionin e Komunave të Kosovës në pajtim me Vendimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës – AKK të datës 23.09.2020, Njoftimit të AKK për kodin ekonomik dhe faturës nr:17/22 të datës 14.04.2022.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, kategoria ekonomike – mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Administratë në xhironlogarinë bankare nr.1901586841031197 në Bankën Kombëtare Tregtare BKT .

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 4100/09-27502
Lipjan, më 05.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e komitetit të auditimit të Komunës së Lipjanit 1Nr.052-48066 të datës 10.05.2020, Rregullores nr. 34/2012 për pagesën e pagave dhe shtesave të kryetarëve / kryesuesve dhe anëtarëve të bordit për rishqyrtimin e ankesave, komiteteve të auditimit, Këshillit kosovar për raportim financiar si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë

VENDIM

PËR EKZEKUTIMIN E PAGESËS PËR KOMPENSIMIN E PUNËS TË KOMITETIT TË AUDITIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT

I. OBLIGOHET, Drejtorati për Buxhet dhe Financa që konform Vendimit të Kryetarit të Komunës për themelimin e komitetit të auditimit të Komunës së Lipjanit 1Nr.052-48066 të datës 10.05.2020, të bëjë ekzekutimin e pagesës për kompensimin e punës së Kryesuesit dhe anëtarit të Komitetit të Auditimit të Komunës së Lipjanit nga shoqëria civile për takimet e mbajtura si vijon:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita në Komitet	Datat e pjesëmarrjes në takimet e komitetit	Shuma për pagesë në €
1.	Fitim Sadiku	Kryesues i Komitetit për Auditim	29.01.2021	120 €
			26.04.2021	120 €
			30.07.2021	120 €
			18.10.2021	120 €
			21.12.2021	120 €
Gjithsej				600 €
2.	Shkëlqim Bahtiri	Anëtar I Komitetit për Auditim	29.01.2021	100 €
			26.04.2021	100 €
			30.07.2021	100 €
			18.10.2021	100 €
			21.12.2021	100 €
Gjithsej				500 €
Gjithsej shuma e përgjithshme për pagesë				600+500= 1100 €

II. Shuma e mjeteve të cekura do të ndahet nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime si dhe ndalesa e kontributeve do të bëhet konform legjislacionit në fuqi.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë .

1Nr. 400-24871

Lipjan, më 17.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, nenit 4 par 4.4 të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 1-453/01-23734 e datës 11.05.2022 e lidhur në mes të Fondacionit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik –PREDA Plus dhe WEntrepreneur dhe Komunës së Lipjanit, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **1,634.50 €** (një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër euro e pesëdhjetë cent), konform nenit 4 par 4.4 të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 1-453/01-23734 e datës 11.05.2022 e lidhur në mes të Fondacionit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik –PREDA Plus dhe WEntrepreneur dhe Komunës së Lipjanit për realizimin e Projektit “Stabilizimi i mëtejshëm i komuniteteve pakicë dhe shumicë në Kosovë përmes mbështetjes së shtuar ekonomike “ në të cilin projekt parashihet mbështetja e 7 bizneseve fillestare nga Komuna e Lipjanit që promovojnë ide krijuese.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2022, kategoria ekonomike –Subvencionet e planifikuara pr Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të OJQ – PREDA PLUS PRILEP nr. 1910950508031242 në BKT.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

INr. 01-400/01-25124
Lipjan, më 18.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 6 dhe 8 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.011-29428 e datës 02.05.2019 si dhe nenit 1 të Rregullores Nr.15Nr-345-70953 e datës 31.10.2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr-011-29428 e datës 02.05.2019, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË OPERATORËVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI DHE VERIFIKIMIN E AUTOMJETEVE

Neni 1

Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë për transportin e udhëtarëve me automjete taksi dhe verifikimin e automjeteve, (në vazhdim të tekstit Komisioni), sipas Njoftimit publik 13Nr.-343-06-22746 të datës 06.05.2022 i publikuar me datë 10.05.2022, në përbërje si vijon:

1. Behar Krasniqi, Kryesues
2. Salihe Marevci, anëtare
3. Rafete Retkoceri, anëtare
4. Rrahman Olluri, anëtar
5. Bujar Curri, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni ka për detyrë që të shqyrtoj aplikacionet e operatorëve për transportin e udhëtarëve me automjete taksi, të cilët kanë aplikuar sipas Njoftimit publik Njoftimit publik 13Nr.-343-06-22746 të datës 06.05.2022 i publikuar me datë 10.05.2022, brenda afatit 20 ditor nga dita e mbylljes së Njoftimit publik.
2. Komisioni shqyrton aplikacionet e cekura në pikën 1 të këtij neni, verifikon automjetet dhe harton Raportin me listën e operatorëve të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e Licencës të cilin ia dërgon Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020-25296
Lipjan, më 18.05.2022





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me Priljeje:	24.05	20	22
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:	
01-112/01-26509			



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.020-78113 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për plotësimin dhe ndryshimin e strukture organizative të administratës së Komunës (Orgonagramit) në këtë përbërje:

1. Vlora Krasniqi, Shefe e sektorit për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore, Kryesuese
2. Shemi Azemi, Shef i sektorit të Tatimit në Pronë, anëtar
3. Xhevahire Zeqiri, Udhëheqëse e Personelit, anëtare

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësit

Detyrë e komisionit është konform dispozitave ligjore në fuqi të hartoj plotësim ndryshimin e Vendimit strukture organizative të administratës së Komunës (Orgonagramit) dhe të njëjtin ndryshim të dërgon të Kryetari i Komunës.

Detyrat e cekura Komisioni do ti kryej më së largi me datë 15.06.2022 duke i precizuar me shkrim Kryetarit të Komunës plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të cekur.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen, Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 1-112/01-26509
Lipjan, më 24.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 të Rregullorës për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak së një vit të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr.463-4312 të datë 19.01.2021 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik për marrjen, shfrytëzimin dhe vendosjen e objekteve të ndryshme në hapësirat publike në fushën e kompetencës nga Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, në këtë përbërje:

1. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuese
2. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar
3. Salihe Marevci, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtare

Neni 2
Detyrat përgjegjësitë dhe mandati

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për shfrytëzimin e hapësirave publike që janë në kompetencë të Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Komisioni do të bëjë shqyrtimin e këtyre kërkesave në bazë të kriterëve të Rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak së një vit të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr.463-4312 të datë 19.01.2021 si dhe Rregullores për vendosjen, ndërtimin dhe largimin e objekteve të përkohshme në pronën publike të Komunës së Lipjanit si dhe dispozitave tjera përkatëse në fuqi dhe pas shqyrtimit i rekomandon Drejtorit të Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim aprovimin apo refuzimin e kërkesës.

2. Mandati i komisionit është dy (2) vite.

Neni 3
Hyrja në fuqi


Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesuesja dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.111/01-25566
Lipjan, më 30.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË LOKALEVE AFARISTE DHE ZYREVE NË PRONËSI TË KOMUNËS

I. Formohet Komisioni për monitorimin e zbatimit të kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve dhe zyreve në pronësi të Komunës, në këtë përbërje: (në vazhdim të tekstit Komisioni)

1. Gafurr Hetemi, Kryesues i komisionit
2. Fatbardha Shurdhiqi, anëtare e komisionit
3. Merita Zeqiri, anëtare e komisionit

II. Komisioni ka detyrë dhe përgjegjësi që:

- Të monitoroj zbatimin e kontratave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të lokaleve afariste dhe zyreve në pronësi të Komunës.
- Të bashkëpunoj me Sektorin pronësor juridik dhe Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim për të vërtetuar se a është bërë pagesa e qirasë brenda afatave të përcaktuara me kontratë si dhe a janë përmbushur obligimet kontraktuese.
- Komisioni është i obliguar që të dalë në teren te secili lokal afarist ose zyre me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike.
- Komisioni ka mandat (3) trevjeçar dhe përgaditë raporte të rregullta për Kryetarin e Komunës. Raportin e parë me shkrim duhet ta përgadis më së largu brenda afatit 20 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi ndërsa pas këtij raporti obligohet të hartojë raporte 6 mujore mbi mënyrën e shfrytëzimit afatshkurtër të lokaleve dhe zyreve në pronësi të Komunës.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit

1Nr. 1-361/03-27711
Lipjan, më 30.05.2022

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

